



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara,
mbajtur më 10.05.2022, e cila filloi në orën 13:30.

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli – Mustafa, kryesuese, dhe anëtarët e Komitetit:
Ramadan Salihu, Mehreme Llumnica, Jeton Canhasi, Gyltene Retkoceri.

Mungoi: Ermira Shabani dhe Armend Ademi.

Në mbledhje ishte e pranishme edhe Premtime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli-Mustafa, me këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuara;
2. Të arriturat e takimeve të realizuara, për të cilat është marrë vendim në mbledhjen e kaluar.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Kryesuesja konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Pika e dytë

Të arriturat e takimeve të realizuara, për të cilat është marrë vendim në mbledhjen e kaluar.

Gyltene Retkoceri theksoi se e kanë realizuar takimin me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ku janë informuar se në muajin maj do të kenë takim, faktikisht do ta kenë një lloj donacioni prej të huajve me të gjitha pikat që kanë mu realizuar dhe me të gjitha kërkesat që i kemi në në Plani e veprimit, vetëm se kanë me i realizuar ata, por kishte edhe pika shtesë.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, pyeti se në muajin maj me kë do të kenë takim.

Premtime Preniqi informoi se takim do të ketë me donatorët për Planin e mobilitetit.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha pyeti se si Komitet a mundemi me ju drejtuar drejtorit të DSHP-së që në këtë takim për Planin e Mobilitetit me qenë ndonjë anëtar i Komitetit.

Premtime Preniqi informoi se Mehremja ishte këmbëngulëse që të jetë ndonjë anëtar i komitetit, por ata nuk u pajtuan se ishin disa takime, dhe në fund del në diskutim publike a ty kemi qasje.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, informoi se në këtë rast po të kishit qenë Premtimja kishte luajtur një rol të veçantë. Njëherësh pyeti se a do të njoftohemi kurë do të dalë në diskutim publik.

Premtime Preniqi tha jo, aty faktikisht është fjala për Komitet në përgjithësi, sa i përket njoftimit për diskutim publikim ai del në ueb-faqe të Komunës dhe 2 javë duhet të jetë në diskutim publik.

Gyltene Retkoceri informoi për çështjet që i kanë diskutuar në takim me drejtorinë e SHP-në, që janë pika në Planin e veprimit. Sa i përket transportit, qasjes për PAK u tha se në publike është në të gjitha, ndërsa në publiko-private, "24 Yjet" e kishin të qasshme, me Planin e mobilitetit parashihet për gjithë transportin.

Për vendosjen e tarifës për lirim nga pagesa, u tha se do të trajtohen njësoj, d.m.th. edhe për transport publiko-privat, se tani në publike janë, me këtë plan do të jenë njësoj.

Për numrin e linjave të autobusëve urbanë u tha se do të rritet dhe do të bëhen me zë, do të bëhet rimodelimi i linjave.

Te lirimi i PAK nga pagesa e shërbimeve komunale në mënyrë të zbritshëm, varësisht nga numrit të anëtarëve të aftësisë së kufizuar, d.m.th. kjo ke ideja një herë, ata kërkuan me ua dërguar një listë, por për arsye se është vështirë me u siguruar ajo listë, u vendos që ata me bërë publike këtë çështje, me pas përparësi me aplikuar vetë.

Premtime Preniqi theksoi se në takim e ceku Mehremja çështjen e taksive, ku çdo kompani që ka mbi 10 vetura duhet të ketë hapësirën për PAK, por vetëm kompania "London Taxi" e ka pasur këtë hapësirë për PAK.

Po ashtu, ceku se e kishte me vete Udhëzimin administrativ për bashkëpronësi, që me u ulur e me pasur si model, se numri i vogël ndoshta është, ndoshta me këtë i jepet mundësia me bartur edhe PAK pjesën e vetë, pronën në emër të tyre.

Gyltene Retkoceri u shpreh se kjo është edhe fushatë vetëdijesuese, hap shumë i mirë. Ky takim ishte pozitiv dhe ky Plan i mobilitetit është i standardeve evropiane nëse do të realizohet.

Premtime Preniqi tha se nga ky takim kemi marrë shumë informacione që nuk i kemi ditur, si për Rregulloren për taksi që ishin duke punuar.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, pyeti për "Prishtina Parking".

Premtime Preniqi dha sqarime, duke thënë se është diskutuar edhe për këtë, ishin duke punuar dhe shumë shpejt ka me ardhur në përfundim dhe gjithsesi ka me qenë ajo që PAK kanë me ua caktuar vendet e parkingut, sa, ku etj.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, i sugjeroi Gyltenes që brenda mundësive, me përgatitur një e-mail dhe me iu drejtuar DSHP-së dhe me i falënderuar për takimin e mirëpritur dhe informatat e ofruara, si dhe të premtojmë bashkëpunim edhe në të ardhmen.

Premtime Preniqi sugjeroi që në e-mail me e përfshirë edhe nënkryetarin, z. Alban Zogaj dhe anëtarët e Komitetit se po informohemi.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha le të përfshihen të gjithë anëtarët e komitetit, se kur po i shohin në si-si të gjithë anëtarët, edhe drejtorët përkatës pe marrin pak më me seriozitet.

Po ashtu, informoi se i kanë bërë ftesë drejtoreshës së Arsimit, znj. Besianë Musmurati që të kenë takim. Është kthyer përgjigja se nuk mundemi me pasur takim me drejtoreshën, por me kërkuar takim me shefin e DKA- së, z. Lulëzim Vrapca dhe znj. Albulena Ahmeti, që është zyrtare për gjithëpërfshirjen. Ne iu kemi drejtuar Lulëzimit dhe Albulenës që të kemi një takim, për të diskutuar për 4-5 pikat që i përkasin kësaj drejtorie që i kemi në PV, por që nuk kemi marrë përgjigje ende, ku qëllimi është te pagesa e transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara që janë në kopshte, që sipas vendimit të ish-kryetarit Shpend Ahmetit lirohen të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta, por mendoj të bëhet kompensimi i të gjithë nxënësve me nevoja të veçanta me një shumë prej 60 € në muaj, ndërsa nuk i përfshijnë edhe fëmijët e kopshteve që e kanë larg relacionin. Qëllimi ynë është me marrë vendimin e kryetarit të më hershëm, me marrë PV-në dhe Vendimin e PV-së dhe me iu drejtuar me këto dokumente që me ndryshuar Vendimin e mëhershëm, me shtuar që të përfshihen edhe fëmijët në institucione parashkollore.

Mehreme Llumnica tha unë kisha vendos me i thirrur nga 2-3 drejtori, por prapë më mirë me shkuar mobil sepse nuk do të vijë.

Premtimre Preniqi tha se më lehtë është me i takuar, me shkua ne.

Mehreme Llumnica theksoi se pasi që drejtoresha e Mirëqenies Sociale veç është në rrjedha për shumicën e problematikave, se kanë projekte, subvencione ju kanë nda OJQ-ve, krejt organizatave që merren me komunitete më të ndjeshme edhe për fëmijë, për kryefamiljar, për të moshuarit, për lloje të aftësive të kufizuara, ku ajo i monitoron. Andaj, mos të humbim kohë me këtë drejtori, të fokusohemi në drejtori e të bëjmë kërkesa nga 2-3 herë, ku kemi probleme, se DMS ka punuar më së shumti, se ka monitoruar projekte dhe kishin projekte të reja.

Ramadan Salihu u shpreh se është dakord me dinamikën e punës së Komitetit, drejtori afron sa ka mundësi, jo më shumë, ajo nuk është pronë private. Sa i përket tatimit në pronë, ky është gabim i yni, te PV -të është formuluar ashtu, sepse drejtorja çdo taksë mundet me liruuar, por tatimet jo, se tatimet nuk janë të drejtorisë, ato janë të shtetit, të Ministrisë së Financave.

Sa i përket takimeve, unë nuk kisha thënë me u takuar me shefa e zyrtarë specifik, se komiteti është një organ konsultativ. Nëse takohet me drejtor në rregull, nëse jo me pritur me u takuar

me drejtor, se të tjerët janë të nivelit më operativ në terren. Kjo dinamikë po më duket e mirë me u kanalizuar, me u qitur në letër dhe me ruajtur komiteti seriozitetin e vetë, e ata e kanë detyrë me u kujdesur për ata njerëz që po flasim ne. Ky PV neve na obligon edhe si Komitet, edhe si Komunë. Jashtë këtij s'kemi si me dalë, ka disa mangësi, si i tillë është i mirë dhe i obligon të gjithë, ndërsa Plani i mobilitetit është trend, ky nuk e obligon askënd. Kishte qenë mirë me u realizuar ashtu siç janë parashikimet e Planit të mobilitetit.

Po ashtu, tha se në takimin e kaluar Mehremja ka cekur se diku 20 PAK kanë me u punësuar. **Mehreme Llumnica** dha sqarime, duke thënë se 20 PAK i kanë kërkuar drejtoresha e MS-së ku 2 sidomos prej komunave, por për shërbime sociale në qendra për Punë Sociale në kuadër të Komunës, tani pritet me dalë konkursi nëpër QPS.

Premtime Preniqi tha se është mirë kur te keni informata që ka konkurse me informuar.

Ramadan Salihu theksoi se KKPAAK mos me qenë në dijeni si po shkon procesi me aftësi të kufizuara, kot unë jam këtu, duhet me konfirmuar, nuk po them se duhet me pasur ndihmë, se unë nuk do të konkurroj në atë konkurs, por komiteti duhet me ditur për çka do që është. Unë po dua me bërë serioz Komitetin.

Premtime Preniqi tha se ne po insistojmë pasi ky Komitet është konsultativ, kjo është arsyeja. Në njëerën anë, ky komitet është themeluar në mandat tjetër, kurse tani ka ardhur një mandat tjerë. PV-të janë bërë mandatin e kaluar, këta nuk e dinë në qoftë si Komitet nuk veprojmë në këtë mënyrë, me ditë me gjetur mënyrën me i informuar këta aktorë, nuk do ta dinë që ekziston PV, ky është njëfarë proces i evokimit të lobimit.

Ramadan Salihu tha se ne nuk llojmë, nuk jemi OJQ, ne jemi mekanizëm i tyre, është si me qenë dorë e zgjatur e kryetarit, d.m.th. na duhet me shkuar me u thënë drejtorëve, p.sh. drejtorit të Administratës na tregoni bashkëpunëtorin adekuat, ne duhet të jemi të informuar prej dorës së parë për secilin proces që zhvillohet për Komitetin e PAK, nuk bën me anashkaluar komitetin për proceset e komitetit dhe ne me kuptuar prej të tjerëve që QPS kinse po i punësoj, ka nga 2 PAK, nëse nuk vendosim kritere ne nuk jemi serioz. Komiteti duhet me pasur një anëtar të vetin aty në komisione, se ia kemi dhënë vetit një rol shtesë monitorues për me i përcjell apo zbatohet kjo 20 kuota, a është mirë konkursi, si po punon komisioni rekrutues etj.

Mehreme Llumnica shprehu mendimin se është bërë një lëshim, që është dashur kur ka qenë nënkryetari, me e qitë këtë si pikë, me ngulë këmbë në komisionet në burimet njerëzore, me qenë një përfaqësues për me monitorua punësimin e PAK-së.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, sugjeroi zotëri Jetonin që me ua dërguar nga një email drejtorëve të Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Drejtorisë së Sportit, NP "Prishtina Parking" NP "Banesore" për me i caktuar terminet për takime, si dhe me i futur në si-si anëtarët e Komitetit.

Jeton Canhasi kërkoi që të ketë ndonjë anëtar për t'i ndihmuar, që bashkërisht me i caktuar terminet.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, kërkoi që deri në takimin e rrallës t'i kryejmë këto përgjegjësi dhe të raportojmë. Njëherësh e sugjeroi zotëri Ramadanin që mundësisht me i ndihmuar për një kërkesë për Drejtorinë e Arsimit, që DA nuk na ka pranuar në takim, në pesë takime që i kemi përcaktuar meqenëse nuk na ka pranuar. Shumë mirë që the se jemi mekanizëm institucional, dhe t'i drejtohem me një e-mail drejtoreshës Besiana, që në si-si me i përfshirë kryetarin, nënkryetarët e aktorë të tjerë. Mua ma përgatit një e-mail të tillë që nuk

na ka pranuar kaherë. Po ashtu, e sugjeroi që me ia përcjell një e-mail me Drejtorisë së Administratës dhe Burimeve njerëzore për takim dhe këtë kohë takohemi me Administratë, me Burimet njerëzore dhe Arsim.

Jeton Canhasi kërkoi sqarim se nëse iu dërgojmë kërkesën për takim dhe nuk kemi përgjigje, si me vepruar, a me iu drejtuar drejtorit apo si.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, u përgjigj se i drejtohesh drejtorit, nëse nuk të përgjigjet prapë e përsërit kërkesën sa here dhe vjen në komitet raporton se sa herë zyrtarisht nuk iu kanë përgjigjur.

Mehreme Llumnica u shpreh se në takimin që do ta keni me Burimet njerëzor, cekeni çështjen e pikës që e kemi pasur për konkurse për prioritet, ashtu edhe te Drejtoria e Arsimit çështjen e komisioneve vlerësues, sepse është koha e regjistrimeve.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, sa i përket komisioneve vlerësuese, unë jam në ekip vlerësues komunal pedagogjik, çka do që të intereson mundem me t'u përgjigjur. Prej muajit tetor e deri tani në muajin maj, janë mbi 70 fëmijë të vlerësuar edhe 80 fëmijë i kemi në listë pritëse, duke ardhur kërkesat prej shkollave, kopshteve. Ky ekip komplet e ka edhe një punë tjetër primare. Unë kam kërkuar nga kryesuesja, Albulena Ahmeti, komplet këtë ekip ta lë në Komunë që të merren vetëm me vlerësime të fëmijëve me nevoja të veçanta, se është shumë vështirë brenda javës me i vlerësuar tre fëmijë e një javë tjetër hiq.

Mehreme Llumnica theksoi se tani është afati i regjistrimit dhe mbesin ata fëmijë të përjashtuar.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha si DKA këta 5 vetë në ekip t'i kishte bërë punëtorë të DKA-së me pagën që e kanë si psikolog, mësues, edukator etj., e me u marrë këta vetëm me vlerësim të fëmijëve, atëherë në rregull. Në këtë mënyrë siç është, me të vërtetë është e pamundur.

Ramadan Salihu kërkoi nga kryesuesja me ia dërguar pikat e takimit për me formuluarë tekstin.

Gyltene Retkoceri tha se mund ta dërgoj unë e-mailin që ia kam drejtuar drejtorit të Shërbimeve Publike.

Mbledhja përfundoi në orën 14 :45.

Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit
Fatime Demolli Mustafa

